



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER GJERGJ R. KONGOLI  
ADRESA NJESIA ADMINISTRATIVE  
NR. 10, RR. KONT URANI, GODINA  
NR. 3  
TEL: 0682033057

# KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

Nr. repertori: 2963

Nr. koleksioni: 1150

Tirane më 23/06/2021




Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"

\*Akti noterial përbëhet nga 2 fletë



A2021053630124765723



## K O N T R A T Ë

(PËR SHITJE KUOTASH)

Sot, në Tiranë më datë 23 / 06 / 2021 (dymije e njezete e nie ) përpara meje Noter Gjergj Kongoli, me seli ne adresen ; Rr “Kont Urani”, Godina Nr.3 , u paraqitën personalisht **PALËT** :

**SHITËSI:** **Albert HANI** , i biri i Muharem e Fatmira , lindur ne Tirane me 06.04.1966 , banues ne adresn ; Rruga “BRUZI” Vila Nr.12 , - 1026 - Tirane, identifikuar me Leter Njoftimi Nr. 033849018, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar.

*(më tej referuar si “Shitësi”)*

**BLERËSI:** **Alban EFTHIMI**, i biri i Romeo e Tamara , lindur në Tiranë, më 13.10.1970, e banues në Tiranë, në adresën: Rruga “Zef JUBANI” P.23. Ap.6 , identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit me nr.personal H01013093A, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar.

*(më tej referuar si “Blerësi”)*

*(te dy së bashku referuar si “Palët”)*

**BAZA LIGJORE:** Nenet 705 e vijues të Kodit Civil (i ndryshuar), nenet 73-75 dhe pika 1 e nenit 88 të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (i ndryshuar).

### DEKLARIME PARAPRAKE

1. Shoqeria “**Al - Selekt 19**” shpk , regjistruar ne QKB me numer identifikimi L81805025J, Administrator i se ciles eshte **Albert HANI**.

2. Shitësi është ortak i vetëm i shoqërisë “AI - Selekt 19” shpk , duke zotëruar kështu 100% të kuotave të kësaj Shoqërie e duke patur pjesëmarrje prej 100% në kapitalin bazë të shoqërisë.
3. Bazuar ne ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, ai është ortak i vetëm i Shoqërisë me 1 (një) kuotë e cila i jep të drejtën e pjesëmarrjes prej 100% në kapital bazë të shoqërisë.
4. Me qëllim realizimin e investimeve të reja në Shoqëri, Shitësi kërkon të shesë 30% te pjeseve takuese qe disponon ne kapitalin e shoqerise.
5. Blerësi është i interesuar të blejë 30% të pjeseve takuese që Shitësit duke u bërë kështu ortak në Shoqëri me 1 kuote e cila perfaqeson 30% te pjeseve te kapitalit te Shoqerise.

Për këto arsye, Palët, me vullnetin e tyre të plotë, të lirë e të pacënuar, vendosin të lidhin këtë Kontratë për Shitjen e 30 % të pjeseve te kapitalit. *(më tej referuar si “Kontrata”)*.

#### **NENI 1**

##### **Objekti**

- 1.1 Objekti i kësaj Kontrate është transferimi me ane te shitjes se 30% te pjeseve te kapitalit te Shoqerise nga Shitësi në favor të Blerësit.

#### **NENI 2**

##### **Çmimi dhe mënyra e pagesës**

- 2.1 Palet kane rene dakord qe pjeset e kaptalit te shiten ne vleren e tyre nominale ne vleren prej 30,000 (tridhjetë mijë) lekë, vlere e cila eshte likujduar.

#### **NENI 3**

##### **Kalimi i pronësisë mbi kuotën**

- 3.1 Blerësi fiton pronësinë me tagra të plota mbi 30% të pjeseve te kapitalit me nënshkrimin e kësaj Kontrate dhe Regjistrimi i kesaj Kontratës pranë institucioneve te nevojshme si QKB e ttj.

#### **NENI 4**

##### **Garancitë e Palëve**

- 4.1 Shitësi garanton Blerësin se:

Zotëron 1 Kuote në Shoqërinë, e cila përfaqëson 100% të kapitalit të saj bazë, i cili është në vlerën 100,000 lekë. Kuota në tërësinë e saj nuk është subjekt sekuestrimi, ndalimi shitje, të drejte parablerje, garancie bankare, apo e ndonjë mjete tjetër i cili siguron ekzekutimin e detyrimeve;

Ka të drejtë, aftësi dhe zotësi të plotë për të vendosur shitjen e Kuotës dhe për të ekzekutuar këtë Kontratë sipas parashikimeve të saj, pa patur nevojën për pëlqimin apo miratimin paraprak të ndonjë personi tjetër, qoftë ky fizik apo juridik;

Përmbushja e kësaj kontrate nuk do të rezultojë në situatë kundërligjshmërie, paligjshmërie apo pavlefshmërie, lidhur me Kontratën në vetëvete, Statutin e Shoqërisë, marrëdhënie detyrimesh mes shoqërisë dhe të tretëve apo Shitësit dhe të tretësve, ose me legjislacionin në fuqi;

Asnjë person i tretë fizik ose juridik nuk ka të drejta mbi kuotën apo kapitalin e Shoqërisë;

Shoqëria, nuk ka detyrime financiare / tatimore ndaj shtetit, të prapambetura..

As shoqëria dhe as vetë Shitësi nuk janë pjesë e ndonjë procesi gjyqësor apo procedimi administrativ, i cili mund të rezultojë në hetimin e Shoqërisë ose në ngarkimin e detyrimeve mbi kuotat, kapitalin ose asetet e shoqërisë;

#### **4.2 Blerësi garanton Shitësin se:**

Ka të drejtë, aftësi dhe zotësi të plotë për të vendosur blerjen e Kuotës dhe për të ekzekutuar këtë Kontratë sipas parashikimeve të saj, pa patur nevojën për pëlqimin apo miratimin paraprak të ndonjë personi tjetër, qoftë ky fizik apo juridik;

Ka ndërmarrë apo do të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme juridike për autorizimin, ekzekutimin dhe regjistrimin e kësaj Kontrate;

Përmbushja e kësaj kontrate nuk do të rezultojë në situatë kundërligjshmërie, paligjshmërie apo pavlefshmërie, lidhur me Kontratën në vetëvete, marrëdhënie detyrimesh mes Blerësit dhe të tretëve, ose me legjislacionin në fuqi;

Blerësi nuk ka detyrime financiare / tatimore, ndaj shtetit të prapambetura.

Palët bien dakord dhe garantojnë se brenda 3 (tre) ditëve kalendarike nga data e nënshkrimit të kontratës do të ndërmarrin çdo hap të nevojshëm, përfshirë ndryshimin e mundshme në Statutit dhe miratimin e tij në Asamblesë të Përgjithshme të Ortakëve të Shoqërisë.

Ndryshimin e numrit të kuotave të shoqërisë nga 1 kuote e cila konsiston në 100% të pjesëve të kapitalit, si mëposhte vijon;

**Z. Alban EFTHIMI bëhet posedues i 1 kuote, e cila përfaqëson 30% të pjesëve të kapitalit, me vlerë nominale 30.000 Leke**

**Z. Albert HANI mbetet posedues i 1 kuote, e cila përfaqëson 70% të pjesëve të kapitalit, me vlerë nominale 70.000 Leke.**

Ndryshimin e strukturës së ortakëve dhe Asamblesë të Përgjithshme të Shoqërisë, nga shoqëri me ortak të vetëm, në Shoqëri me dy ortakë;

Administrator i Shoqërisë do vazhdojë të jetë Albert HANI

Se për të gjitha detyrimet e Shoqërisë përpara lidhjes së kësaj Kontrate, përgjegjësi për shlyerjen e tyre do të mbartet vetëm nga Shitësi, i cili ka detyrimin të paguajë çdo detyrim të komunikuar brenda afateve ligjore nga fondet e tij personale.

## **NENI 5**

### **Interpretimi i kontratës**

5.1 Kushtet e përcaktuara në këtë kontratë interpretohen pa u ndalur në kuptimin letrar të fjalëve, por duke pasur parasysh qëllimin e vërtetë të palëve, që i ka shtyrë për nënshkrimin e këtij akti. Kushtet e kontratës interpretohen njëri nëpërmjet tjetrit, duke i dhënë secilit kuptimin që del nga tërësia e aktit. Në rast dyshimi, kontrata ose kushtet e saj interpretohen në kuptimin në të cilin mund të kenë ndonjë efekt dhe jo në atë, sipas të cilit nuk do të kishte ndonjë efekt.

5.2 Ligji i zbatueshëm për interpretimin e kësaj Kontrate do të jetë legjislativi në fuqi në Republikën e Shqipërisë, e më specifikisht, nenet 705 e vijues të Kodit Civil (i ndryshuar), si

dhe nenet 73-75 dhe pika 1 e nenit 88 të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (i ndryshuar).

***Bashkëlidhur dhe pjesë integrale e kësaj Kontrate janë:***

Kopje e letërnjoftimit të palëve nënshkruese;

Ekstrakt nga regjistri tregtar i Shoqërisë “Al Selekt 19” shpk;

Vendimi i Asamblesë për miratimin e shitjes së Kuotave.

*Palet, atëzohet Znj. Jrida Beoni, të kryej të gjitha veprimet e nevojshme ligjore, pranë QKB dhe çdo organi tjetër, për regjistrimin e kësaj Kontrate si dhe depozitimin e dokumentave, (Vendime Asambleje etj) për ndryshimet e mundshme në Statutin e Shoqërisë.*

**P A L E T**


**SHITËSI:**



**Albert HANI**



**BLERËSI:**



**Alban Efthimi**



**NOTER**

**Gjergj R. Kongoli**

